



A.nr.726/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malësore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bektashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës numër A.nr.726/2026, të datës 01.07.2026, të parashtruar nga ankuesja B.D , nga Mitrovica, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës Veriore, në çështjen juridike-administrative “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.08.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.726/2026, e datës 01.07.2026, e parashtruar nga ankuesja B.D.

II. Anulohet Vendimi me numër protokoli 01-030/01-001-324/26, i datës 16.06.2026, i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Vendimi me numër protokoli 09-030/01-0009558/26 i datës 08.06.2026, i Drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, ashtu që, lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent respektivisht tek Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore.

III. Obligohet Drejtori i Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimi të bëjë rivlerësimin e periudhës provuese për ankuesen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e vendimit.

IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore të përkujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile B.D (në tekstin e mëtejshëm referuar: *Ankuesja*) më datë 01.07.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 01-030/01-001-324/26, të datës 16.06.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Vendimit me numër protokolli 09-030/01-0009558/26, të datës 08.06.2026, të Drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit në Komunën e Mitrovicës Veriore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 09.07.2026 e ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Mitrovicës Veriore, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.07.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2901/2026 të datës 01.07.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 01-030/01-001-324/26 të datës 16.06.2026 të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore; Vendimin me numër protokolli 09-030/01-0009558/26 të datës 08.06.2026, të Drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit në Komunën e Mitrovicës Veriore; Raporti i punëve 2026; Emailin për dërgimin e raporteve mujore nga ankues për V.O datës 16.02.2026, 02.03.2026, 01.04.2026, 30.04.2026, 02.06.2026, dhe 16.06.2026; Emailin e datës 30.04.2026 nga ankuesja për V.O; Emailin e datës 29.04.2026 nga V.O për ankuesen; Komunikimin me telefon; Emailin e datës 22.05.2026 nga ankuesja për L.F; Emailin e datës 22.05.2026 nga ankuesja për B.GJ; Emailin e datës 22.05.2026 nga B.GJ për ankuesen; Konkursin për pozitën Insekt i Shërbimeve Publike i datës 27.08.2025; Vendimin A.nr.265/2026 i KPMSHCK-së; Kopjen e ID-së së ankuses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.07.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 21.07.2026; Akt Emërimit e datës 03.12.2025 të ankesës; Përshkrimin e punës për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike; Certifikatën e trajnimit hyrës për nëpunësit e ri civil në shërbimin civil të Kosovës shkurt 2026; Emailin e datës 15.07.2026 nga V.O për L.F se bashku me raportin e punës për muajin maj 2026 të ankuses; Emailin e datës 15.07.2026 nga V.O për L.F.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, **sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se:

- Ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 01-030/01-0019492/25, të datës 03.12.2025, ka themeluar marrëdhënie punës për pozitën Inspektor i Shërbimeve Publike në Drejtorinë e Inspekcionit të Komunës së Mitrovicës Veriore, ku kohëzgjatja e periudhës provuese ka qenë gjashtë muaj.
- Drejtori i Drejtorisë së Inspekcionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, më datë 08.06.2026, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 09-030/01-0009558/25, me të cilin nuk konfirmohet marrëdhëniet e punës për ankuesen, me arsyetimin se nuk ka përmbushura detyrat e punës përkatësisht ka pasur *mangësi në aftësi për komunikim të drejtpërdrejtë me qytetaret dhe palët e interesuara, pamundësi për kryerjen e pavarur të detyrave të punës, përfshirë trajtimin e kërkesave dhe ankesave për shkak të nevojës për asistencë nga persona të tretë; mos marrje e përgjegjësi për reagim në rastet e shkeljes së ligjit dhe akteve në fuqi; efikasitet të zvogëluar dhe zgjatja e procedurave për shkak të hezitimit në komunikim dhe veprim të drejtpërdrejtë; bashkëpunim i kufizuar me institucionet për shkak të kompetencave të pamjaftueshme; pamundësi për të kryer në mënyrë të pavarur detyrat e inspektimit për shkak të mungesës së punës profesionale dhe praktike dhe kontroll dhe veprime jo adekuate me vetiniciativë sipas ligjit dhe akteve në fuqi.*
- Si rezultat i Vendimit me numër protokolli 09-030/01-0009558/25, të datës 08.06.2026, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore më datë 16.06.2026 ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 1-030/01-0010324/26, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin numër protokolli 01-030/01-001-324/26, të datës 16.06.2026, të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore dhe Vendimin numër protokolli 09-030/01-0009558/26 të datës 08.06.2026, të Drejtorit të Drejtorisë së Inspekcionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, me pretendimet së vendimet e kontestuara nuk gjejnë mbështetje faktike dhe juridike për shkak që nuk janë vërtetuar drejtë faktet, nuk përcaktohet se cilat detyra nuk janë përmbushur, në cilat raste është konstatuar performanca e pakënaqshme dhe të tjera që ndërlidhet me konfirmimin e periudhës provuese. Në mungesë të provave të konstatuar në mënyrë të drejtë, nuk janë evidentuar asnjë rast se kam refuzuar zbatimin e punëve dhe nuk është nxjerr përfundim se performanca ime ka qenë e dobët apo e pakënaqshme. Shton se ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm rastesh, ka dorëzuar rregullisht raportet mujore të punës. Kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimet e kontestuara dhe ta kthejë në vendin e saj të punës sipas aktit të emërimit më të gjitha të drejta dhe detyrimet.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike ju referua:

- Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 86 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. *Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative.* 2. *Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”.*

- Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenit 51, ku përcaktohet: 1. *Nëpunësja/i civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistes/it në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të këtij ligji, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët.* 2. *Gjatë periudhës provuese, nëpunësja/i kryen trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë.* 3. *Nëpunësja/i civil, gjatë periudhës provuese nuk mund të transferohet dhe nuk mund të marrë pjesë në komisione që themelohen nga institucionet për të cilat kërkohet përvojë profesionale.* 4. *Para përfundimit të periudhës provuese, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e rezultateve të punës për këtë periudhë.* 5. *Në fund të periudhës provuese, mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunëses/it, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë vendos:* 5.1. *konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunëses/it në shërbimin civil;* 5.2. *zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunëses/it;* 5.3. *moskonfirmimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të nëpunëses/it dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil.*

-Rregullores (QRK) Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil përkatësisht nenin 23 dhe 24, ku përcaktohet: Neni 23: 1. *Nëpunësi civil që emërohet për herë të parë në pozitë të kategorisë profesionale apo të specialistit në shërbimin civil, apo që merr mandatin sipas nenit 46 dhe 49 të LZP-së, i nënshtrohet periudhës provuese që zgjatë gjashtë (6) muaj nga data e nënshkrimit të aktit të emërimit nga të dy palët.* 2. *Puna provuese është përgatitja teorike dhe praktike e nëpunësit për kryerjen me sukses të detyrave të pozitës ku është emëruar.* 3. *Puna provuese pezullohet për kohëzgjatjen aktuale të pushimit të lehonisë, pushimit të atësisë, pushimit prindëror, pushimit mjekësor, fushatës zgjedhore dhe/apo rrethanave të tjera të veçanta. Pas përfundimit të shkakut të ndërprerjes, periudha e provës zgjatet për kohën sa është bërë ndërprerja.* 19/20 4. *Nëpunësi civil, gjatë periudhës provuese nuk mund të transferohet dhe nuk mund të marrë pjesë në komisione që themelohen nga institucionet për të cilat kërkohet përvojë profesionale.* Neni 24: 1. *Njësia përgjegjëse tridhjetë (30) ditë para përfundimit të periudhës provuese, kërkon me shkrim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil që të bëjë vlerësimin e punës provuese.* 2. *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë zhvillon takim me nëpunësin civil, jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para përfundimit të punës provuese dhe bashkë me të trajton performancën e tij.* 3. *Njoftimi për takimin lidhur me vlerësimin e punës provuese të nëpunësit civil i dërgohet nëpunësit civil së paku tre (3) ditë para datës së takimit.* 4. *Mbështetur në vlerësimin e rezultateve të punës të nëpunësit civil, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë vendos:* 4.1. *konfirmimin e marrëdhënies së punës të nëpunësit në shërbimin civil;* 4.2. *zgjatjen e periudhës provuese një herë të vetme, deri në gjashtë (6) muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuara ka qenë i pamundur*

vlerësimi i plotë i nëpunësit; 4.3. moskonfirmimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil të nëpunësit, përmes vlerësimit të arsyetuar. 5. Vendimin e arsyetuar për konfirmimin ose moskonfirmimin e punës së nëpunësit, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë e dërgon tek njësia përgjegjëse së paku dhjetë (10) ditë para përfundimit të punës së tij provuese. 6. Në rast të moskonfirmimit të marrëdhënies së punës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, njësia përgjegjëse merr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Përfundimisht, në rast të moskonfirmimit të periudhës provuese të të emëruarave në kategori drejtuese të cilët kanë qenë të punësuar në shërbimin civil para marrjes së mandatit, të njëjtët sistemohen në një pozitë të kategorisë profesionale nga njësia përgjegjëse./

Ndërlidhur me dispozitat ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 09-030/01-0009558/26 të datës 08.06.2026, të Drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, dhe si rrjedhojë vlerëson se konstatimet e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses në vendimin për mos konfirmim të periudhës provuese nuk kanë mbështetje ligjore dhe faktike mbi arsyet se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme pa argumentuar se cilat detyra nuk ka përbushë ankuesja, nëse ankuesja kishte refuzuar përmbushjen e detyrave apo kishte refuzuar kërkesat për përmbushje të detyrave të punës.

Rrjedhimisht, nëse ankuesja nuk kishte performancë të mirë në punë atëherë, bazuar në legjislacionin si me lartë gjatë periudhës provuese nëpunësja/i kryen trajnimet e detyrueshme dhe kryen detyrat nën mbikëqyrjen e mbikëqyrëses/it të drejtpërdrejtë, veprim ky i paraparë me 51 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, ndërsa, sipas provave materiale të lëndës, nuk evidentohet ndonjë komunikim mes mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë dhe ankueses për mos realizim të detyrave të saj, kurse ankuesi tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka dërguar raportet mujore përgjatë periudhës së vlerësimit, dhe nuk ka prova që këto raporte janë kundërshtuar.

Për më tepër nga shkresat e lëndës Kolegji nuk verën se ndaj ankueses ishte dhënë ndonjë vërejtje në kuptim të respektimit të orarit, sjelljes në punë apo komunikim të pa përshtatshëm me mbikëqyrësin, nëpunësit apo me publikun, e mbi këto rrethana dhe fakte Kolegji nuk e pranon si të drejtë dhe të bazuar Vendimin me numër protokolli 09-030/01-0009558/26 të datës 08.06.2026, të Drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore për mos konfirmim të periudhës provuese të ankueses.

Kolegji i Këshillit po ashtu konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankueses ka tejkaluar autorizimet e tij ligjore me rastin e nxjerrjes së vendimit të kontestuar sepse i njëjti nuk ka kompetencë që me rastin e konfirmimit apo mos konfirmimit të periudhës provuese të vlerësojë nëse ankuesja kishte plotësuar kushtet e përvojës së punës profesionale të përcaktuar me konkurs, sepse, një vlerësimi i tillë përben çështje të ndarë dhe ka trajtim tjetër të ndarë ligjor, andaj, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër protokolli 09-030/01-0009558/26 i datës 08.06.2026, i Drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore, është nxjerr në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë, pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme dhe si i tillë konsiderohet akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që, duke

qenë se mbi bazën e këtij vendimi është nxjerr Vendimi me numër protokolli 01-030/01-001-324/26 i datës 16.06.2026 i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Veriore, atëherë, edhe ky akt vlerësohet si i paligjshëm.

Thënë si më sipër, pas e duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht anuloi aktet e kontestuar më ankesë dhe detyroi Drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Mitrovicës Veriore që në ri procedurë të bëjë vlerësimin e periudhës provuese për ankuesen duke respektuar në plotëni dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetim të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.726/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses B.D ;
- Komunës së Mitrovicës së Veriut Organit: Kryetarit të Komunës, Drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMSHCK-së.